



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
MINISTARSTVO UNUTRAŠNJIH POSLOVA
MINISTRY OF INTERNAL AFFAIRS

KOSOVO CENTER FOR PUBLIC SAFETY EDUCATION AND DEVELOPMENT
QENDRA E KOSOVËS PËR SIGURI PUBLIKE EDUKIM DHE ZHVILLIM
KOSOVSKI CENTAR ZA JAVNU BEZBEDNOST OBRAZOVANJE I RAZVOJ

Duke u bazuar në rregulloren 2001/36, Urdhëresën administrative 2003/2 dhe Udhëzimin Administrativ 2003/01, Qendra e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim në Vushtri shpallë:

RI - SHPALLJE

K O N K U R S I

Titulli i Pozitës: **Instruktur për Çështje Ligjore**

Raporton : Shefit te Sektorit Ligjor

Kohëzgjatja e kontratës: Sipas Ligjit mbi Shërbimin Civil

Paga mujore: 250.80 €

Koeficienti: 7

Vendi : **Vushtri**

Qëllimi i postit: Ligjerim, interpretim, analizim, sqarim, përkrahje dhe mbështetje ligjore për të gjitha departamentet, sektorët dhe zyrat në QKSPEZH., përkrahje dhe harmonizim i plan-programeve mesimore sipas ligjeve në fuqi në Republikën e Kosovës, bashkëpunimi me institucionet e ndryshme, punë juridike nga marrëdhënja e punës si dhe përfaqësim të autorizuar të QKSPEZH-it në institucionet vendore.

Detyrat kyçe:

- Ligjërime në kurse të ndryshme,
- Interpretimin, analizimin dhe sqarimin e të gjitha çështjeve ligjore,
- Përkrahja dhe mbështetja ligjore për të gjitha departamentet, sektorët dhe zyrat e veqanta në kuadër të QKSPEZH-it,
- Përkrahja dhe harmonizimi i plan-programeve mesimore sipas ligjeve positive në Kosovë,
- Bashkëpunim me institucionet relevante në Kosovë, Gjykat ,Prokurori etj.,
- Të gjitha punët juridike që kanë të bëjnë nga sfera e mardhënjesë së punës,
- Përfaqësim i autorizuar i QKSPEZH-it, në institucionet vendore.

Përgjegjësitë kyçe:

- Ligjerim, interpretim, analizim, sqarim, përkrahje dhe mbështetje ligjore,
- përfaqësim, harmonizim i plan-programeve mësimore,
- Ofrimi i shërbimeve cilësore nga Sektori për Përkrahje Ligjore, lidhur me çështjet ligjore.

Shkathtësitë kyçe, aftësitë dhe përvoja, ju lutemi specifikoni nëse është e nevojshme apo e dëshirueshme:

- Aftësi të dëshmuara për analizimin e nevojave për ligjerim, e nevojshme
- Shkathtësi të dëshmuara të zhvillimit dhe mbajtjes së ligjerimit, e nevojshme
- Menaxhim të grupeve gjatë ligjerimit dhe punës me pjesëmarrësit në trajnim, e nevojshme
- Të ketë shkathtësi të dëshmuara dhe efektive të komunikimit me shkrim dhe me gojë, e nevojshme

Kualifikimet arsimore dhe profesionale për post:

- Diploma e Fakultetit Juridik
- Provimi i Jurisprudences meret si Përparësi (e dëshirueshme).
- Përvoja pune profesionale juridike se paku 2 vjet.
- Njohuri të shkëlqyeshme të punës me kompjuter, me aplikim të programeve (Word, Excel, Power Point).

Paraqitja e kërkesave. Formularët e kërkesave mund të merën dhe të dorëzohen në Qendrën e Kosovës për Siguri Publike Edukim dhe Zhvillim respektivisht zyrën e personelit nr. 101, adresa Rr.Skenderbeu pn. Vushtrri. Data e mbylljes së kërkesave 15 ditë pas shpalljes në ndonjë nga gazetatat zyrtare të Kosovës.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit për aplikim nuk do të merën parasysh ndërsa kërkesat e pakompletuara dhe ata të cilët nuk i kanë kualifikimet adekuate nuk do të meren parasysh dhe nuk do të shqyrtohen dhe pranohen.

Tel kontaktues 028/70-008 lok 114 në rast të ndonjë paqartësie dhe këshille.

Në rast të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e listës së ngushtë do të ftohen për intervistim.

Shërbimi Civil i Kosovës i shërben të gjithë popullit të Kosovës, dhe mirëpret aplikacionet prej meshkujve dhe femrave prej të gjitha komuniteteve në Kosovë.